

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.R. nga fsh. ..., Komuna e Podujevës, për shkak të veprës penale falsifikim i parasë nga neni 302 par. 2 të KPRK-së, duke vendosur për ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av. B.S., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.nr.216/2017, të dt. 22.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, me datë 27.04.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit I.R., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Prishtinë, PKR.nr.216/2017, të dt. 22.02.2018 vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore - DKR në Prishtinë, me aktgjykimin PKR.nr.216/2017, të dt. 22.02.2018, të akuzuarin I.R. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale falsifikim i parasë nga neni 302 par. 2 të KPRK-së, dhe për këtë vepër penale e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, dënim ky i cili do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të akuzuarin e ka detyruar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të shumës së paushallit gjyqësor, shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues dhe atë konfiskimin e 24 copë banknote në vlerë prej nga 50,00 €, me nr. serik të përshkruar si në vërtetimin për konfiskimin e sendeve me shenjë 2016-AB-2353, si mjete me të cilat është kryer vepra penale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit av. B.S., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje, apo të ndryshohet të akuzuarit t'i shqiptojë dënim sa më të butë dhe njëkohësisht ta lirojë nga detyrimi për kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, për të cilën njoftoi Prokurorinë e Apelit, të dëmtuarin, të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm mbrojtësi av. B.S., ndërsa, edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantuan Prokurori i Apelit, e as i akuzuari I.R., për të cilin mbrojtësi i të akuzuarit gjykatën e njoftoi se i njëjti për shkak të gjendjes shëndetësore nuk prezantoi në seancën e kolegjit. Në seancën e kolegjit, mbrojtësi i të akuzuarit av. B.S., pasi më parë sqaroi disa nga pretendimet ankimore, ngeli në tërësi pranë propozimeve si në ankesë.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/I.nr.142/2018, të dt. 30.03.2018, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar

Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit I.R., av. B.S., në ankesë, edhe pse shprehimisht nuk e thotë nga arsyetimi i ankesës rezulton se pretendohet që aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 12 të KPPK, ngase, pra, gjithëherë sipas pretendimeve ankimore, arsyetimi i aktgjykimin të ankimuar është i paqartë, konfuz dhe kundërthënës me vetë veten, ngase, në faqen 2 par. 2 të arsyetimit konstatohet “në asnjë fazë të procedurës penale deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë”, pastaj në faqen 5 par. 2 konstatohet “...për të akuzuarin gjykata si rrethanë lehtësuese konsideroi pranimin e fajësisë” si dhe kundërthënie të njëjta gjen edhe në faqen 2, par. 3, ku thuhet “...gjatë shqyrtimit gjyqësor i mundësoi të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të akuzuarit”, mirëpo nga shikimi i shkresave në lëndë e sidomos procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se i akuzuari I.R., nuk e ka pranuar fajësinë, nuk ka pasur mbrojtës si dhe të njëjtit nuk i është ofruar asgjë nga shkresat e lëndës e duke përfshirë këtu edhe një kopje të aktakuzës, prandaj edhe i akuzuari nuk ka pasur njohuri që t'i shfrytëzojë të drejtat e tij procedurale konform dispozitave të nenit 245 të KPPK-së. Po ashtu, kur jemi tek arsyetimi i aktgjykimin të ankimuar e sidomos tek dhënia e arsyerave për faktet vendimtare është me rëndësi të cekët se i tërë arsyetimi kryesisht bazohet në deklaratat e dëshmitarit E.Sh., të akuzuarit I.R. dhe ekspertizës përkitazi me falsifikimin e kartëmonedhave, prova këto të gjitha në kundërthënie njëra me tjetrën, nga të cilat edhe ashtu nuk vërtetohet gjendja faktike e përshkruar më detajisht si në

dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Po ashtu, pretendohet se deklarata e dëshmitarit E.Sh. është provë e papranueshme, ngase, e njëjta është kundërthënëse dhe atë përveç me vetë veten edhe me provat tjera e sidomos me ekspertizën në shkresat e lëndës, ekspertizë kjo në të cilën konstatohet se bëhet fjalë për falsifikim të pjesëshëm, prandaj, janë të gjitha këto shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që domosdoshmërisht ndikojnë në anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo Gjykatë e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e lartë përmendura ankimore janë të pabazuara, ngase nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara nga neni 384 par. 1 nën par.12 të KPPK, nga se dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, kështu që sa i përket përmbajtjes së dispozitivit të aktgjykimit, i njëjti nuk ka asgjë konfuzë dhe se në përmbajtjen e tij janë paraqitur të gjitha veprimet inkriminuese të akuzuarit e që përbëjnë elementet e veprës penale për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtor. Po ashtu, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsyerat të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje penale-juridike, duke u bazuar së pari në vetë deklaratën e të akuzuarit, i cili nuk i ka mohuar faktet dhe rrethanat se pasi më parë ka marrë kartelën bankare nga dëshmitari E.Sh., përmes të njëjtës ka futur në bankomatin e bankës "Raiffaisen" bankënotat në shumë prej nga 50 €, gjithsejtë 1.200 €, në llogarinë e dëshmitarit E.Sh., të cilat bankënota nga bankomati në fjalë menjëherë janë veçuar në vendin e paraparë për para të dyshimta, fakte këto dhe rrethana që janë vërtetuar po ashtu, edhe nga deklarata e dëshmitarit E.Sh., pastaj, ekspertiza e Agjencisë për Fornezikë-Sektorit për Ekspertimin e Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve, ku është vërtetuar se bankënotat në fjalë janë të falsifikuara, arsye këto të mjaftueshme faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361 par. 2 kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par. 7 të KPPK, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyerash i merr si të provuara ose si të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore, pra ka marrë parasysh edhe deklaratën e të akuzuarit i cili pretendon se nuk e ka ditur se bankënotat janë të falsifikuara, pra, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë. Prandaj, përveç që qasja ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme, po ashtu, as një fakt nuk ka ngelur i pa qartësuar ose i pavërtetuar dhe përveç që janë vërtetuar drejtë ato edhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë. Kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale, duke konstatuar gjendjen faktike të vërtetuar më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, kuptohet pra, duke u bazuar në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor dhe se gjatë paraqitjes së arsyerave për faktet vendimtare në arsyetim nuk ka paqartësi dhe konfuzitet, sikur që pretendohet në ankesë, ngase, kur është fjala për vërejtjet që bëhen përkitazi me faqen 2, 3 dhe 5 të arsyetimit, nuk bëhet fjalë për konfuzitet por janë marrë fjalë të ndara nga fjalia e që kuptohet pastaj, nëse interpretohen si të vetme, pra, pa fjalinë në tërësi, atëherë mund të fitohet përshtypja se janë fjalë të paqarta dhe konfuzë, gjë që, në realitet nëse merren si tërësi me fjalinë, atëherë nuk ka asgjë konfuzë dhe të paqartë, sikur që pretendohet në ankesë. Po ashtu, aktgjykimi i ankimuar nuk bazohet në provat të papranueshme, sikur që pretendohet në ankesë, ngase, deklarata e dëshmitarit E.Sh. është marrë në përputhshmëri të plotë me dispozitat procedurale të parapara për marrjen në pyetje sipas KPPK-së, duke përfshirë procedurën paraprake por edhe shqyrtimin gjyqësor, gjë që të njëjtën gjë, gjykata

e shkallës së parë, e ka bërë edhe përkritazi me deklaratën e të akuzuarit I.R., po ashtu, nuk qëndron pretendimi ankimor se bëhet fjalë për prova të papranueshme kur është fjala për ekspertizën e Agjencisë për Fornezikë-Sektorin për Ekspertimin e Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve, ngase e njëjta është marrë konform dispozitave ligjore dhe se nga konkludimi i ekspertizës në fjalë me pa mëdyshje vërtetohet se bëhet fjalë për bankënotat të falsifikuara. Edhe sa i përket pretendimeve ankimore në kuptim të drejtës së mbrojtjes – pra, angazhimit të mbrojtësit, kjo gjykatë vlerëson se pretendimet në fjalë janë të pabazuara, ngase, në bazë të shkresave në lëndë, vërtetohet se i akuzuari qysh në fazën paraprake është njoftuar për të drejtat e tij, duke përfshirë edhe të drejtën e mbrojtjes dhe angazhimin e mbrojtësit – pra, avokatit, mirëpo, i akuzuari, gjegjësisht i pandehuri, ka hequr dorë nga e drejta në fjalë shprehimisht dhe atë duke nënshkruar edhe personalisht, gjë që, të njëjtën deklaratë – pra, për heqje dorë nga e drejta e angazhimit të mbrojtësit e ka bërë edhe në seancën e shqyrtimit fillestar, që do të thotë se i njëjti nuk ka dashur të angazhojë mbrojtës, ndërsa, duke pasur parasysh veprën penale për të cilën ka qenë i akuzuar, mbrojtja nuk ka qenë e detyruar, prandaj, edhe nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në këtë drejtim, sikur që pretendohet në ankesë.

Pretendimet ankimore përkritazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe gjetjet e gjykatës.

Përkritazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, me ankesë në esencë kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë të bazë të provave të proceduara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, prandaj, edhe përfundimet kanë pasuar të gabuara, pa mbështetje në prova, për çka i akuzuari I.R., është dashur që të lirohet nga akuza e Prokurorisë Themelore- DKR në Prishtinë. Sipas pretendimeve ankimore, përkritazi me këtë bazë ankimore, pretendohet se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka konstatuar se ka vërtetuar gjendjen faktike duke u bazuar në deklaratat e të akuzuarit, të dëshmitarit dhe ekspertizës përkritazi me falsifikimin e bankënotave në fjalë, ngase, nga provat në fjalë, nuk vërtetohet gjendja faktike sikur që konstaton gjykata e shkallës së parë, prandaj, me këtë njëkohësisht është bërë edhe shkelja e ligjit penal, në dëm të akuzuarit ku i njëjti është shpallur fajtor si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë, ngase, nga vetë mbrojtja e të akuzuarit, pra, në mënyrë të pa kontestuar, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se i akuzuari I.R., pasi më parë i kishte marrë kartelën bankare dëshmitarit E.Sh., ka shkuar në bankomatën e Bankës "Raiffeisen Bank" në Prishtinë, ku ka deponuar në llogarinë e dëshmitarit E.Sh., shumën e të hollave në lartësi prej 1.200 €, të gjitha këto në bankënota në shumë prej nga 50 €, ku pasi i deponon paratë në fjalë, nga bankomati i bllokohet kartela dhe paratë në fjalë mbesin brenda në bankomatë në vendin e paraparë për paratë e dyshimta, për çka pastaj, i akuzuari pasi më parë e njofton dëshmitarin për bllokimin e parave në ndërkohë është ftuar edhe nga administrata e bankës dhe është njoftuar për arsyerat e bllokimit të parave – pra, për shkak të dyshimit se të njëjtat janë të falsifikuara. Faktet dhe rrethanat në fjalë, gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitarit E.Sh., i cili deklaron po thuajse në tërësi sikurse i akuzuari, vetëm se përkritazi me arsyerat e marrjes së kartelës bankare dhe shfrytëzimit të llogarisë së dëshmitarit nga ana e të akuzuarit, për çka deklaron ndryshe nga ajo që ka deklaruar i akuzuari, ngase, ky dëshmitar deklaron se kartelën bankare ia ka marrë me qëllim të deponimit të parave në llogarinë e tij dhe pastaj transferimin e tyre në llogari tjetër, por jo se i ka pasur borxh dëshmitarit, sikur që deklaron i akuzuari. Ndërsa, përmes ekspertizës së Agjencisë për Fornezikë-Sektorin për Ekspertimin e Dokumenteve dhe

Dorëshkrimeve, janë vërtetuar faktet dhe rrethanat që nuk kontestohet as nga vetë i akuzuari, se bankënotat në fjalë të cilat janë deponuar nga i akuzuari në bankomatit e Bankës “Raiffeisen Bank” e në llogarinë e dëshmitarit E.Sh., të cilat pastaj, bankomati në fjalë i ka ndarë në vendin e caktuar enkas të paraparë për paratë e falsifikuara.

Ndërsa, përkitazi me faktet kontestuese, se a e ka ditur i akuzuari se bankënotat në fjalë janë të falsifikuara, gjykata e shkallës së parë, përveç fakteve dhe rrethanave të vërtetuara si më lartë, ka marrë parasysh edhe deklaratën e vetë të akuzuarit i cili në deklaratën e dhënë në procedurë paraprake, ka deklaruar se nga dëshmitari E.Sh., ka marrë kartelën bankare me qëllim që ta bëjë deponimin e parave në llogarinë e tij dhe t’ia paguajë borxhin, ndërsa, në deklaratën e dhënë në shqyrtimin gjyqësor e ka mohuar një gjë të tillë, duke deklaruar se paratë në fjalë ka dashur t’i deponojë e pastaj t’i transferojë në llogarinë e tij, me qëllim të pagimit të borxheve në emër të ndërmarrjes së tij, pra, ndryshe ka deklaruar në fazën paraprake të procedurës e ndryshe tani në seancën e shqyrtimit gjyqësor. Pastaj, në deklaratën e seancës së shqyrtimit gjyqësor vetë i akuzuari nuk i ka mohuar faktet dhe rrethanat se paratë e falsifikuara i ka marrë nga një person i dyshimtë, por tani për tani nuk dëshiron ta jap emrin e atij personi, që do të thotë se i akuzuari e ka ditur se bankënotat janë të falsifikuara. Përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë, pra, se i akuzuari e ka ditur se bëhet fjalë për bankënotat e falsifikuara, gjykata e shkallës së parë, ka marrë parasysh edhe deklaratën e dëshmitarit E.Sh., të cilit – pra, dëshmitarit në fjalë, i akuzuari i kishte kërkuar kartelën bankare me qëllim që të deponojë paratë në fjalë, e pastaj, të njëjtat t’i transferojë në llogari tjetër, që do të thotë se, qëllimi ka qenë që paratë e njëjta t’i dorëzojë si të falsifikuara e pastaj të nxjerrë bankënota tjera origjinale.

Prandaj, duke pasur parasysh mbrojtjen e të akuzuarit në seancën e shqyrtimit gjyqësor por edhe deklaratën e dëshmitarit E.Sh., i cili përshkruan mënyrën dhe rrethanat se si i akuzuari i ka kërkuar kartelën bankare dhe të njëjtën e ka shfrytëzuar për deponimin e parave të falsifikuara, gjykata e shkallës së parë, me pa mëdyshje ka konstatuar se i akuzuari e ka ditur se bëhet fjalë për paratë e falsifikuara dhe se me qëllim e ka shfrytëzuar llogarinë e dëshmitarit ashtu që duke i deponuar bankënotat në fjalë në bankomatit të “Raiffeisen Bank”, ka dashur që ta bëjë ndërrimin e të njëjtave, ashtu që, pastaj, të njëjtat t’i nxjerrë si bankënota origjinale dhe t’i shfrytëzojë për nevojat e veta, gjegjësisht, ndërmarrjes së tij.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e sipër përmendura si dhe rrethanat dhe arsyerat më detajisht të theksuara në aktgjykimin e ankimuar, rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari I.R., është kryes i veprës penale falsifikim i parasë nga neni 302 par. 2 të KPRK-së, është i drejtë dhe se në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarrë veprimet inkriminuese të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, prandaj, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të akuzuarit nuk janë të bazuara.

Në ankesën e të akuzuarit, përkitazi me këtë bazë ankimore theksohet se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është i ashpër, gjegjësisht, nuk është në përputhje me qëllimin e përgjithshëm të dënimit konform dispozitave të nenit 41 të KPK-së, pastaj, se nuk janë marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të parapara konform dispozitave të nenit 74 par. 3 të KPK-së, dhe atë sidomos rrethana se i akuzuari nuk ka qenë i dënuar më parë, pastaj, sjellja e të akuzuarit

pas kohës së kryerjes së veprës penale por edhe fakti se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, prandaj edhe propozon që të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit siç parasheh dispozita e nenit 73 të KPK-së. Pretendimet e të akzuarit, nuk janë të bazuara nga se rrethanat të cilat cekën me ankesë, të njëjtat janë marrë parasysh nga gjykata e shkallës së parë dhe asnjëra nga rrethanat e cekura në ankesë nuk janë rrethana të asaj rëndësie që të kenë ndikim të drejtë për drejtë në shqiptimin e dënimit më të butë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë. Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e konstatuara në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, mënyrën se si është kryer vepra penale – pra, duke shfrytëzuar kartelën bankare të personit tjetër, rezultojnë se dënimi të cilin i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, të akzuarit është i drejtë dhe i ligjshëm, po ashtu, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akzuarit, është në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPK-së.

Në ankesën e mbrojtësit të akzuarit edhe pse nuk cekët baza ankimore përkitazi me vendimin për shpenzimet procedurale, nga përmbajtja e arsytimit të ankesës rezultojnë se me ankesë kundërshtohet edhe vendimi për shpenzimet procedurale dhe atë me arsytim se i akuzuari nuk e ka gjendjen e mirë materiale, dhe se në rastin konkret i njëjti nuk mund ta përballojë edhe kompensimin e shpenzimeve procedurale, për çka, ka kërkuar që të lirohet nga kompensimi i shpenzimeve procedurale.

Gjykata e Apelit, mori parasysh edhe këtë pjesë të ankesës, mirëpo, të njëjtin e refuzoi si të pabazuar, ngase, në bazë të dispozitave të nenit 453 par. 4 të KPPK-së, kërkesën në fjalë duhet t'i paraqitet gjykatës së shkallës së parë, për të cilën kompetentë për vendosje është kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari që ka vendosur për çështje penale juridike, pastaj vetëm nëse vendimi në fjalë kundërshtohet atëherë për këtë vendos Gjykata e Apelit, prandaj, edhe ankesën në fjalë e refuzoi si të pabazuar.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.148/2018, të datës 27.04.2018

Procesmbajtësi,
Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit,

Kryetari i kolegjit,
Abdullah Ahmeti

1. Xhevdet Abazi

2. Have Haliti

